

Akademik Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: STUDIMET PËR SHQIPTARËT NË FRANCË¹

Të nderuar kolegë, miq të dashur,

Sot po përurojmë vëllimin e akteve të Konferencës shkencore ndërkombëtare me temën “Studimet për shqiptarët në Francë”, ff. 638, të mbajtur në mjediset e ASHAK-ut në Prishtinë më 29-30 tetor 2021 me organizim të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe të Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut. Në konferencë, e cila ishte parashikuar të mbahej më 2020, por për shkak të rrethanave me pandeminë u desh të shtyhej, megjithatë u mbajt në rrethana të vështirësuar të pandemisë, morën pjesë mbi 40 pjesëmarrës nga vende të ndryshme. Në serinë e konferencave shkencore që synojnë të sjellin një pasqyrë vrojtimesh për zhvillimet e studimeve albanistike në botë (janë mbajtur tri të tilla: për Amerikë, për botën gjermanishtfolëse dhe për Itali), kjo konferencë sjell risinë e zgjerimit të vrojtimeve nga albanistika në tërë horizontin e studimeve për shqiptarët, përfshirë udhëpërshkrimet e format e tjera të vështrimit. Horizonti i vështrimeve këtë herë përfshinte aspektet historike-shoqërore e politike, me shumë interes lidhur me zhvillimet në Francë në kohët e vona e sidomos lidhur me Kosovën. Kishim parasysh se shqyrtimet për shkrimet e studimet për shqiptarët në Francë kishin nisur herët me të dijshmin M. Fra-shëri te *Diturija* në vitet '30 të sh. XX, kishin vazhduar më vonë me autorë si Y. Jaka, e më vonë L. Rama, F. Andrea, A. Papa, etj., ishin mbajtur dy konferenca shkencore me tematizim të këtillë – në Shkodër më 2001 – *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (208 ff) dhe në Tiranë më 2012 – *Shqipëria dhe Franca: vështrime dhe shkrime të kryqëzuara* (224 ff). Botimet e akteve të tyre kanë sjellë vështrime me interes lidhur me shqyrtimet për Shqipërinë në Francë, lidhur me vështrimet filologjike-gjuhësore e kulturore dhe vetëm dy vështrime-raportime lidhur me problematikat e Kosovës dhe të shqiptarëve jashtë Shqipërisë.

¹ Fjalë e mbajtur në përurimin e botimit, 15 qershor 2022 në Prishtinë.

Në Kosovë kemi një traditë studimesh dhe interesimesh për gjuhën dhe kulturën frënge që shkon te vitet '50 të sh. XX dhe intensifikohet në vitet '70 të atij shekulli nga grupi i intelektualëve filofrancezë në fushën e kulturës, apo paralelisht me të përmes veprimtarisë sistematike të Degës, më vonë Departamentit të romanistikës/ Gjuhës dhe letërsisë frënge të FF të UP, deri tash nuk ka pasur ndonjë veprimtari të këtij niveli dhe të këtyre përmasave. Ka pasur vështrime të herëpashershme në kuadër të veprimtarisë së Seminarit, të IAP, etj. Siç shihet nga botimi, përmasat e kësaj Konference dhe prurjet e saj rezultuan shumëfish më produktive në raport me tubimet e kësaj natyre më parë.

Kontaktet e regjistruara të botës shqiptare me botën frënge janë të hershme, por janë intensifikuar në sh. XX. Më intensive kanë qenë në kohën pas Skënderbeut, pastaj në kohën e Ali Pashë Tepelenës, në valën e romantizmit dhe në fillim të shekullit XX, kur po përvijoheshin konturat e shteteve të reja të Europës. Lëvizje me rëndësi si Lidhja e Prizrenit kishin qenë më pak të pranishme në opinionin e atjeshëm. Periudha e shtetit të pavarur të Shqipërisë kishte tërhequr vëmendjen e opinionit frëng në nivele të ndryshme. Deri në atë kohë mbisundonin udhëpërshkrimet me shënime të shumta, dëshmi dhe përshkrime të gjendjes. Deri nga fundi i luftërave ballkanike dhe themelimi e rikonfigurimi i shteteve në opinionin frëng mbisundonte ideja për tërësinë e botës shqiptare në Ballkan, ndërsa pastaj mbisundojnë vështrimet vetëm për shtetin shqiptar. Izolimi komunist shqiptar vetëm sa e rriti dendësinë e perdes së atillë, kështu që pjesët e botës shqiptare jashtë shtetit të vitit 1913 sikur ishin lënë në heshtje.

Në vitin 1901 konsulli francez në Shkodër A. Degrand veprën *Souvenirs de la haute Albanie* e përfundonte kështu: "*Nuk besoj të ketë në Europë një popull më pak të përgatitur për ta pranuar njerëz dhuratë kaq të shtrenjtë, por nganjëherë të rrezikshme, që quhet liri, e të cilën të tjerë e kanë blerë me një çmim nga më të lartit dhe me skrifca nga më të dhimbshmet.*" Ndërkaq më 1913 përshtypjet e G.-L. Jaray flisnin për energji e entuziazëm, për lëvizje krejt të ndryshme nga ato që kishte hetuar konsulli një dekadë më parë:

"Një gjuhë e përbashkët, një ndjesi shqiptare pak a shumë e zgjuar, e megjithatë gjithandej latente, një tip fizik, një territor; asnjë komb tjetër nuk përmbledh kaq veçori të përbashkëta për të gjithë bijtë e tij; gjithsesi, është një komb që po lind, dua të them që po rilind... mali dhe politika kanë mbyllur brenda kufijve dhe brenda vizioneve të ngushta fise që, deri tash, kanë qenë të paimteresuara për një veprim të përbashkët shqiptar; por ngjarjet e viteve krejt të fundit i kanë përshpejtuar gjërat, i kanë ndryshuar pikëpamjet dhe i kanë ngjallur ndjesitë e përbashkëta. Më 1908 Shqipëria ishte 'en puissance'; ajo nuk ishte bërë krejtësisht e vetëdijshme për veten; më 1912 shqiptarët e afirmojnë fuqinë e tyre, kohezionin e tyre dhe kombësinë e tyre duke hedhur poshtë shtypjen turke dhe duke hyrë fitimtarë në Shkup".

Në vitet e mëtejme, më 1915 e sidomos më 1918/19, pas prerjes së kufijve në dëm të shqiptarëve e në dobi të fqinjve të veriut e të jugut, ishin bërë diskutime edhe në opinionin e gjerë lidhur me pretendimet e të tjerëve edhe për atë pjesë të Shqipërisë. Ato kishin marrë përmasa të atillë sa që kryetari i Komisionit të studimeve për konturat e Europës së Re më 1918/19, Jean Brunhes ishte detyruar t'ua kujtonte anëtarëve se Shqipëria tashmë kishte qenë dëmtuar ndjeshëm, i ishin marrë Kosova, Rrafshi i Dukagjinit e Çamëria, prandaj nuk duhej të ndahej më tej. Të tilla diskutime po bëheshin në vigjilien e Konferencës së Versajës, pas së cilës bota shqiptare përtej kufijve mbeti e heshtur në opinionin europian dhe francez.

Në fillim të viteve '70 të sh. XX në INALCO pati hapësirë për studimet e gjuhës shqipe, H. Boissin kishte njohuri jo të pakta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Gut e të tjerë merrnin pjesë në zhvillimet në vend dhe shkruanin për to, megjithatë, në opinionin e gjerë dihej më pak për realitetin. Hulumtime serioze për botën shqiptare po ndodhnin dhe në qendra të tjera e në ndërlidhje me interesa përtej gjuhës, si ato të A. Rey, A. Ducellier, P. Cabanes, G. Castellan, G. de Rapper, N. Clayer, sidomos vepra substanciale për shqiptarët në ish-Jugosllavi e M. Roux, etj.

Në fushën e letrave do të priten vitet '70 për të parë një interesim më thelbësor për krijimtarinë e këtij populli. Informacione jo të shumta për letërsinë shqipe mund të gjen-deshin në botime të pakta të natyrës enciklopedike. Interesimet që zgjoi vepra e I. Kadaresë

bënë që të shtroheshin pyetje më të mëdha për ato njohje. Hapja që vinte nga Prishtina përmes Seminarit, ku merrnin pjesë të interesuar nga Franca, i zgjeroi sadopak horizontet dhe solli një dritare për njohjen edhe të realiteteve të Kosovës.

Shpërthimi i vitit 1981 në Kosovë solli në vëmendje të opinionit francez në mënyrë brutale një realitet të harruar, apo më parë të heshtur. Shkrimet qenë të shumta nga të interesuarit për fatin e Jugosllavisë e serbofilët jo të paktë, si artikulli i M. Obin-it lidhur me mitin serb të Kosovës e me historinë ashtu si ishte paraqitur ajo, pra me një *"të drejtë historike serbe mbi Kosovën"*, që te ne, në prill 1981, duhej të përkthehej si vështrim miratues për reagimet ashtu brutale të autoriteteve. Historiani A. Ducellier jepte një shpjegim më të nuancuar, tregonte se e vërteta historike ishte ndryshe nga ajo që paraqitej, porse vërente se kjo nuk ishte e lehtë të shprehej, për shkak se në Francë ishte krijuar atmosferë tjetër: *"shtypi boton në shtyllat e tij vetëm materialet e atyre që përkrahin 'tezën serbe', që konsiderohet e vetëkuptueshme, prandaj çdo zë që nuk pajtohet me të, mbetet i izoluar dhe duket si i frymëzuar nga një 'albanofil' që konsiderohet i dyshimtë a priori"*. Shkrimi i tij priti disa muaj që të botohej.

Persistenca e lëvizjes paqësore dhe përshkallëzimet e represionit bëjnë që opinionin francez të mos mbetej indiferent, e kjo nxiti një shkallë të re interesimesh intelektuale, shkencore e hulumtuese, të shoqatave për të drejtat e njeriut, të opinionistëve të revoltuar për botën shqiptare në vitet '90 e më tej. Kështu kemi dhe një interesim të veçantë për zhvillimet kulturore e letrare, përkthimet e para të letërsisë që zhvillohet në hapësirat jashtë Shqipërisë londineze dhe për tërësinë e kulturës shqiptare. Duket se edhe studimet për shqiptarët po hyjnë në një fazë të re.

Vitet '90 të sh. XX bashkë me rrëfimet për apartheidin të dëshmuar nga vetë intelektualët frëngë, nga shoqatat për mbrojtjen e të drejtave e të lirive të njeriut, nga shoqatat fetare të krishtera, nga sindikatat e veprimtarët politikë, bashkë me historinë e qëndrestarisë paqësore, të veprimit të tërë sistemit shkollor jashtë godinave dhe sistemit arsimor shtetëror, në Francë po vinte historia e veprimtarëve të kulturës, e letërsisë dhe e frymës

që sundonte ndër ne në përpëlajtjet për çlirim. E tërë kjo i dha një shtysë të re interesimit për letërsinë, kulturën dhe dijen shqiptare në përgjithësi, të Kosovës në veçanti. Ndodhte një dialog specifik në rrethana gati surreale. Mendimtarë theksimisht paqësorë po bëheshin përditshëm të pranishëm në një mjedis me halle ekzistenciale. Intelektualë të shquar si A. Garapon, P. Henry Lévy, E. Morin, P. Garde, A. Brossat, J.-Y. Potel, O. Mongin, M.-F. Allain, M. Roux, A. Ducellier, P. Hassner, A. Glucksmann, P. Ricoeur, C. Lefort, etj. me praninë e tyre të gjerë në tematizimet për Kosovën i dhanë vulën krijimit të një opinioni të ri në Francë të rëndësishëm edhe për vendimet që do të merrte shteti pastaj. Mendoj se kjo ka sjellë një bazë të re për dialog dhe bashkëpunim.

Ndonjëherë leximi i kujdesshëm i literaturës së prodhuar atje do të na bënte të mundshme të kuptojmë gjëra që nuk kemi mundësi të marrim vesh drejtpërsëdrejti, si ta zëmë shënimi në një fjali të shkurtë nga Michel Sivignon, i afërt me Quai d'Orsay, në veprën autoritative kolektive *Histori e Adriatikut* të vitit 2001 (përgatitur nga P. Cabanes e të tjerë, shqip më 2005), si kjo: "*Mbase po ecet drejt një ndarjeje të Kosovës sipas modelit boshnjak*". A kemi qenë të vëmendshëm për indikacione të tilla? Do të jenë ato vetëm reflekse personale, apo mbështeten në informacione të natyrave të tjera, nuk e dimë?

Në këtë përrurim të rezultateve të punës së kësaj konference, që solli vështrime me interes për idetë frënge për shqiptarët në faza të ndryshme të historisë, për ndërthurjet kulturore e letrare, për interesimet e këtij shteti të fuqishëm, shpesh me ndikim vendimtar në zhvillimet gjeopolitike në Europë, më në fund për fatin dhe zhvillimet në Kosovë në periudhat vendimtare drejt pavarësisht të saj, dua të falënderoj në radhë të parë pjesëmarrësit, kumtuesit e zellshëm, të ftuarit nga Franca, nga Italia, e nga vende të tjera të botës, kolegët nga Shqipëria dhe nga viset e tjera shqiptare, kolegët e dy seksioneve të ASHAK-ut, anëtarët e Këshillit organizues të Konferencës, kolegen prof. dr. Nerimane Kamberi nga Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Frënge të UP-së, pa angazhimin dhe ndihmën e të cilëve kjo punë nuk mund të realizohej.